



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, 08 dhjetor 2009, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mursel Halijli, Teuta Hadri, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore,

Nga Ministria e Shëndetësisë; Flakron Sylejmani, nga kompania Philip Morris; Elton Stefani, Nga shoqata e duhanxhinjve pranë OEK; Driton Shuki dhe Shpresa Peroli (OEK); Nga AKK; Shqipe Arifi; nga KDI; Rrezarta Ahmeti, nga OSBE – ja; Lejla Selimi, nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/1-36;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.

Qamile Morina – Propozoi që orari i mbajtjes së mbledhjeve të komisionit të ndryshoi, sepse ajo është anëtare edhe në një komision tjetër, i cili ka mbledhje në të njëjtën orë.

Sadik Idriz – Tha se lidhur me këtë do të diskutojmë, besoj që do të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/1-36

Sadik Idriz – Tha se komisioni ka shqyrtuar propozimamendamentet e grupit punues. Në këtë mbledhje komisioni do të votoi për këto propozimamendamentet. Ata të cilët kanë ndonjë propozim konkret mund ta bëjnë këtë.

Gjylnaze Sylja – Propozoi që në nenin 6 të Ligjit pika V fjala “*juaj*” të fshihet dhe të zëvendësohet me fjalën “*tuaj*”.

Në nenin 5 të Projektligjit, paragrafi 6.5 i ligjit të riformulohet si në vijim “*Vërejtja shitesë shtypet në faqen e pasme, më të dukshme të njësisë së paketimit të prodhimeve të duhanit dhe duhet të përfshijë 40% të kësaj sipërfaqeje përveç mbështjellësve të tejdukshëm*”.

Bujar Bukoshi -Tha se ky është një problem lektorimi dhe përkthimi.

Mursel Halilji – Tha se nuk mund të themi në sipërfaqen tjetër më të dukshme, sepse cila është kjo sipërfaqe tjetër më e dukshme.

Elton Stefani, Philip Moris- Propozoi që Komisioni të bëjë interpretimin e drejtë të nenit 8 paragrafi 8.3, pasi që fjalia e fundit e këtij neni, bie ndesh me pjesën e parë të këtij neni. Nëse qëllimi i këtij neni është që mos të ndaloj vendosjen e produktit të duhanit në pikën e shitjes, atëherë fjalia e fundit po e bënë një gjë të tillë.

Teuta Hadri - Tha se ky nen nuk ka për qëllim ndalimin e vendosjes së produktit, por qëllimi është që produkti të jetë i fshehur nga publiku i përgjithshëm.

Gjylnaze Sylja – Tha se qëllimi është që duhani nuk guxon të jetë produkti i parë i cili shihet nga jashtë. Ky nen nuk është kontradiktor, sepse thotë “*...produkti mund të vendoset në përputhje me ligjin...*”.

Flakron Sylejmani, MSh- Tha se dispozitat e mëhershme e sqarojnë që reklamimi i duhanit është i ndaluar. Sipas këtyre dispozitave, në pikën e shitjes lejohet një informatë për duhanin me informata plotësuese shëndetësore. Fjalia e fundit e kësaj dispozite ka për qëllim që të pamundësoj tendencën e reklamimit të duhanit.

Bujar Bukoshi – Lidhur me nenin 8.3, tha se vendosja dhe reklama shpeshherë dinë të dyzohen dhe të unifikohen. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e shëndetit publik.

Rita Hajzeraj – Pjesa e parë e nenit 8.3 me pjesën e dytë janë kontradiktore. Sipas pjesës së parë lejohet reklama për duhanin, por e shoqëruar me informata shëndetësore, tani

edhe pakoja e cigares ka këto informata dhe kjo i bie që është reklamë. Është një diskrepancë këtu, sepse si pakoja e cigares që ka këtë informatë për shëndetin, ashtu edhe vendosja e njoftimit –reklamës së madhe me informata shëndetësore, është e njëjta gjë.

Nurishahe Hulaj – Tha se ka konsultuar ekspert të ndryshëm, nëse duhani duhet të vendoset në vend të fshehtë apo në vend të dukshëm dhe ka marrë përgjigje që duhet të jetë në vend të fshehtë. Për mbrojtjen e shëndetit publik neni 8.3 i ligjit nuk duhet të ndryshohet.

Flora Brovina – Vendosja e produktit fshehur është shumë e rrezikshme, sepse mund të shitet çfarëdo malli. Duhani është mall që shitet.

Mursel Halilji – Me këtë ligj ne nuk po ndalojmë pirjen e duhanit dhe nuk mundemi në të bëhemi aq të ashpër sepse në të kundërtën do të krijohen mekanizma që ligji të shkelet. Nëse e fshehim duhanin atëherë nuk shoh arsye pse të shesim duhan. Vendosja e produktit nuk përbën reklamë por vetëm informacion. Mendoj që duhet të jetë një pjesë e posaçme e dyqanit ku shitet duhani.

Sadik Idriz – Tha se kemi qëndrime të ndryshme lidhur me këtë. Por asnjëri nuk ka propozuar amendament. A ka dikush nga anëtarët e komisionit mendim që kjo pikë të ndryshohet. Ky nen nuk është kontradiktor, sepse nuk ndalon vendosjen e produktit në pikën e shitjes, por kjo vendosje e prodhimit duhet të jetë e fshehur nga publiku i përgjithshëm.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstaton që neni 8 paragrafi 8.3 i ligjit mbetet i pandryshuar.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi ftoi anëtarët e komisionit për të votuar amendamentet e propozuara dhe konstatoi se

Komisioni miratoi amendamentet e propozuara:

Amendamenti 1

Neni 2 i Projektligjit riformulohet :

Në nenin 4 të ligjit paragrafi 4.1 fjalia ,, Qeveria e Kosovës apo Institucioni i autorizuar nga ajo’’ fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë ,, Ministria e Shëndetësisë’’

Në nenin 4 të ligjit, paragrafin 4.4 fjalia ,, Qeveria e Kosovës ’’fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë ,, Ministria e Shëndetësisë’’

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 4.5 , riformulohet:

Testimet për substancat e përfshira në pikën 3 të nenit 4 duhet të bëhen me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë përmes zbatimit të standardeve ISO. Duhet të përdoren këto standarde, ISO standardi 4387 për katranin, 10315 për nikotinën dhe 8454 për monoksidin e karbonit. Saktësia e paraqitjes të sasisë së katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në paketim verifikohet përmes ISO standardit 8243. Ministria e Shëndetësisë siguron ISO standardet 6 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi.

Në nenin 4 të ligjit paragrafi 4.8 riformulohet :

Në qoftë se përbërja e mostrës së marrë nga një seri e prodhimeve të duhanit, dëshmohet nga laborator i licencuar se nuk i përmbahet vlerave të parapara me ligj atëherë ajo seri tërhiqet nga tregu.

Në nenin 4 të ligjit paragrafin 4.9 fjalja „Institucion i autorizuar nga Qeveria e Kosovës” fshihet dhe zëvendësohet me fjalinë „ Ministria e Shëndetësisë”

Amendamenti 2

Pas nenit 6 të Projektligjit shtohet nen i ri me përmbajtje :

Ne nenin 7 të ligjit paragrafin 7.1 në rreshtin e dyte fshihet fjalja “organeve përgjegjëse” dhe zëvendësohet me “Ministrisë së Shëndetësisë”

Në nenin 7 të ligjit paragrafin 7.6 fshihet fjalja „Organet kompetente” dhe zëvendësohet me fjalën „ Ministria e Shëndetësisë “

Amendamenti 3

Pas nenit 6 të Projektligjit shtohet neni i ri me këtë përmbajtje :

Në nenin 10 të ligjit , pas paragrafit 10.3 shtohet paragraf i ri 10.4 me këtë përmbajtje :,, Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha mjetet e transportit publik”

Amendamenti 4

Pas nenit 6 të Projektligjit shtohet neni i ri me këtë përmbajtje :

Në nenin 11 të ligjit paragrafin 11.3 , në fund të këtij paragrafi shtohet fjalja „Kryesues i këshillit profesional për kontrollin e duhanit është ministri i shëndetësisë” .

Amendamenti 5

Neni 7 i Projektligjit riformulohet:

Nenin 14 i ligjit ndryshohet plotësohet me tekstin si vijon:

14.1. Prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit janë të obliguar që në afat prej 12 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji të vendosin shenjzimet në paketimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuar me këtë Ligj.

14.2 Institucionet,organizatat e të gjitha llojeve si dhe mjetet e transportit publik, janë të obliguara që në afat prej 4 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vendosin shenjat e ndalesës së pirjes së duhanit dhe të përcaktojnë vendet ku mund të pihet duhani në qoftë se është e përcaktuar me ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 15

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz